


Klasa e II dhe e III KENGUR 2015

Koha në disponim është 1h e 15 min.

Për përgjigje jo të saktë të pyetjes minusohet një e katërta e numrit tëi pikëve me të cilat vlerësohet kjo pyetje. Për të shmangur rezultat të përgjithshëm negativ në fund shtohen 30 pikë, kështu që sasia maksimale e pikëve të fituara është 150.

Cdo detyrë me numër rendor nga 1 deri 8 vlerësohet me 3 pikë

1. Cila prej figurave nuk është në të gjitha vizatimet ?





- (A) (B) (C) (D) (E)

2. Sa trekëndësha ka në vizatimin e mëposhtëm?



- (A) 7 (B) 6 (C) 5 (D) 4 (E) 3

3. Cila figurë duhet të vendoset që të formohet shtëpia?





4. Pesë nuselale fluturuan në një shkurre. Sa pika kanë të pesta nuselalet së bashku?

- (A) 17 (B) 18 (C) 19
(D) 20 (E) 21



Garë ndërkombëtare Kengur viti 2015

5. Miri ka 10 shufra metalike të njëjta. Ai ngjiti shufrat dy e nga dy dhe formoi pesë shufra më të gjata. Cila shufër është më e shkurtër?




- (A) A (B) B (C) C (D) D (E) E

6. Në figurë është paraqitur kenguri Kërcimtar. Figura mund të rrotullohet por nuk lejohet të përmbysset. Cila prej figurave të mëposhtme mund të fitohet?



- (A) (B) (C) (D) (E)

7. Cilindri dhe konusi janë bashkuar si në figurën djathtas. Trupin e fituar Miri e shikon nga lart. Çfarë shikon Miri?



8. Sa është shuma e numrave që ndodhen jashtë katrorit?

- (A) 30 (B) 60 (C) 90
(D) 45 (E) 100

52	9	24
48	21	36


Cdo detyrë me numër rendor nga 9 deri 10 vlerësohet me 12 pikë






9. Lules i duhet gjysëm ore që të përshkojë gjysmën e rrugës nga shtëpia për në shkollë. Sa kohë i duhet Lules të shkojë nga shkolla në shtëpi?

- (A) 15 minuta (B) gjysëm ore (C) 1 orë
(D) 2 orë (E) 40 minuta

Garë ndërkombëtare Kengur viti 2015

10. Miri ka dy kuadre të njëjtë të formuar nga dy kube. Cilin prej objekteve të mëposhtme nuk mund t'a ndërtojë Miri ?




- (A)  (B)  (C)  (D)  (E) 

11. Miri kishte 9 kulaçe, ndërsa Lulja kishte 17 kulaçe. Sa kulaçe duhet t'i japë Lulja Miri në mënyrë që të dy të kenë të njëjtin numër kulaçesh ?






- (A) 2 (B) 3 (C) 4 (D) 5 (E) 6


12. Në vizatim janë paraqitur gjashtë kuadre të formuar nga kube gri dhe të bardha. Sa kube të bardha ka ?

- (A) 10 (B) 11 (C) 12
(D) 18 (E) 30



13. Cila pjesë mungon ?

- (A)  (B)  (C) 
(D)  (E) 



14. Shifra 5 përmbahet tre herë në shënimin e datës 5.5.2015 (dita,muaji dhe viti).Data më e afërt në shënimin e së cilës shifra 5 do të jetë përsëri tre herë është:


- (A) 5.5.2025 (B) 15.6.2055 (C) 15.5.2050
(D) 25.5.2015 (E) 15.5.2015

15. Për ditëlindjen e Lules nëna e saj porositi 2 pica dhe çdo picë e ndau në 8 pjesë. Në ditëlindje,së bashku me Lulen kishte 14 fëmijë .Sa copë pica mbetën, nëse çdo fëmijë hëngri nga një copë picë?

- (A) 5 (B) 4 (C) 3 (D) 2 (E) 1

16. Numrat 1, 2, 3, 4 dhe 5 shënoi në kuadratet, në secilin kuadrat nga një numër të ndryshëm në mënyrë që llogaritjet të jenë të sakta.. Cili numër qendron në kuadratin ku është pikpyetja ?

- (A) 1 (B) 2 (C) 3
(D) 4 (E) 5




Cdo detyrë me numër rendor nga 17 deri 24 vlerësohet me 5 pikë

17. Në një pistë gare ka 11 flamurë. Flamuri i parë gjendet në fillim të pistës, ndërsa flamuri i fundit në fund të pistës. Largësia midis çdo dy flamurëve fqinjë është 8 metra. Sa e gjatë është kjo pistë ?

Garë ndërkombëtare Kengur viti 2015

(A) 24 metra (B) 48 metra (C) 72 metra (D) 80 metra (E) 88 metra

18. Kenguri Kërcimtar gjendet në rrethin S dhe me një kërcim mund të kalojë në rrethin fqinj. Në sa mënyra të ndryshme pas 4 kërcimesh, Kërcimtari mund të arrijë tek rrethi F?




(A) 3 (B) 4 (C) 5 (D) 6 (E) 7

19. Një anije u sulmua nga piratët. Njëri pas tjetrit piratët, ngjiteshin me litar në anije. Kapiteni i piratëve gjendej në mes, por ishte njëkohësisht i teti duke filluar nga fillimi. Sa piratë ishin në litar?

(A) 7 (B) 8 (C) 12 (D) 15 (E) 16

20. Gjatë 3 ditëve, maçoku Tom kapte minj. Çdo ditë Tomi kapte nga dy minj më shumë se ditën e mëparshme. Ditën e tretë maçoku Tom kapi dy herë më shumë minj sesa ditën e parë. Sa minj kapi gjithsej maçoku Tom gjatë tre ditëve?




(A) 12 (B) 15 (C) 18 (D) 20 (E) 24

21. Miri dhe Lulja ndërtojnë kështjellë prej dëbore. Çdo orë Miri bën 8 tulla prej dëbore, ndërsa Lulja bën dy tulla prej dëbore më pak. Sa tulla prej dëbore do të bëjnë Miri dhe Lulja së bashku për 3 orë?

(A) 14 (B) 30 (C) 42 (D) 48 (E) 54

22. Me kube të vegjël gri dhe të bardhë Miri ndërtoi kub të madh (shiko vizatimin). Kubet me të njëjtën ngjyrë nuk kanë faqe të njëjtë. Cili prej pohimeve të mëposhtme e përshkruan numrin e kubeve që i përdori Miri?




- (A) Në kub ka një kub gri më shumë sesa kube të bardhë.
 (B) Në kub ka një kub të bardhë më shumë sesa kube gri.
 (C) Në kub ka numër të njëjtë kubesh gri dhe të bardhë.
 (D) Në kub ka dy kube të bardhë më shumë sesa kube gri.
 (E) Në kub ka dy kube gri më shumë se kube të bardha.

23. Nga kampi veror u larguam në orën 16:32 dhe arritëm në vendin e dëshiruar në orën 6:11 të ditës tjetër. Sa kohë zgjati udhëtimi?

(A) 13 orë e 39 minuta (B) 14 orë e 39 minuta (C) 14 orë e 21 minuta
 (D) 13 orë e 21 minuta (E) 2 orë e 21 minuta

24. Numrat 3, 5, 7, 8 dhe 9 janë shkruar në katrorët e figurës së dhënë, në mënyrë të tillë që shuma e numrave të shënuar në kolonë është e njëjtë me shumën e numrave të shënuar në rresht. Cili numër është shkruar në qendër të figurës?



(A) 3 (B) 5 (C) 7 (D) 8 (E) 9